



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. _____ Prot

Datë _____/_____/2025

PROCESVERBAL
TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS VUMBLO – PILUR”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45233120-6** Punime ndërtimi për rrugë

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës **200,000,000** (Dyqind milionë) lekë **pa TVSH** , vënë në dispozicion nga **buxheti i Bashkisë Himarë**.

- **Viti 2025 100,000,000** (njqind milionë) **pa TVSH**.

- **Viti 2026 100,000,000** (njqind milionë) **pa TVSH**.

Perlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogarit të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së

parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/entitkontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi

i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** dhe **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40 %** e vlerës së përllëgoaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor të delaruar në organet tatimore.
- iv. Aktin e Kolaudit të objektit
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

- vi. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor të delaruara në organet tatimore.
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 45 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve huridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**

- **NP.1** – Punime Germimi ne toke **Klasifikimi A**
- **N.P. 4** - Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale **Klasifikimi D**
- **NP-5**- Punime nentokesore, ura dhe vepra arti **Klasifikimi A**
- **NP-7** Ujesjellesa,gazsjellesa,vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje **Klasifikimi A**

- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**

- **NS-6**- Sinjalistike rrugore jo ndruicuese **Klasifikimi A**
- **NS-7**-Barriera dhe mbrojtje rrugore **Klasifikimi A**
- **NS-18** Punime topogjeodezike **Klasifikimi A**

** Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”,neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në
---------------------	--	--	-------------------------------------	---

			kategorinë respektive	kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	3.124/1a Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir 3 > 3.89/b Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjeresi > 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet (tombinot) 3.164/1a Mbushje me material të germuar në trupin e rruges, përhapur e ngjeshur me makineri >.	A	0-21 milion
NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	3.164/1a Mbushje me material të germuar në trupin e rruges, përhapur e ngjeshur me makineri > 3.198 Cilindrim kasonete me rul > 3.211 Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, përhapur e ngjeshur me makineri (rruga) 3.164/1a Mbushje me material të germuar në trupin e rruges, përhapur e ngjeshur me makineri (tombino) 3.164/1b Mbushje me çakell e gur gurore në trupin e rruges, përhapur e ngjeshur me makineri (tombino box) 3.164/1b Mbushje me çakell e gur gurore në trupin e rruges, përhapur e ngjeshur me makineri (parkimi) 3.211 Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, përhapur e ngjeshur me makineri (parkimi) 3.222/2 Shtrese binderi me granit gur kave, 6cm, me makineri (rruga) etj.	D	101-200 milion
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	3.366 Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni > 3.367 Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni > 3.321 Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M15 > etj.	A	0-21 milion
NP-7	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje	2.197 Hidrozolim me emulsion bitumi dhe katrama > An Hapje mikrotuneli me mikrosonde për kalim të linjave të ujesjellesit/elektrike që intersekojnë rrugën kryesore >	A	0-21 milion
NS-6-	Sinjalistike rrugore jo ndruicuese	11. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA 12. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITESË. NGADALËSUESIT E SHPEJTESISE 13. B. SINJALET HORIZONTALE	A	0-21 milion
NS-7	Barriera dhe mbrojtje rrugore	3.185 F.V guardrail- N2 anësore me 2 valez. në 1 anë, W4 >	A	0-21 milion

NS-18	Punime topogjeodezike	Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh. 3.400/1 Mbrojtja e shpateve nga renia e gureve me rrjete teli orjentim ne nje drejtim, me hapje heksagonale 8x10 te perforcuar ne drejtimin 300gjatesor me kavo celiku anesore. > etj	A	0-21 milion
-------	-----------------------	--	---	-------------

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001 - 2015** (Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë), e përditësuar
- **ISO 14001-2015** (Për sistemin e menaxhimit të mjedisit) e përditësuar
- **ISO 45001-2023** (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)
- **BS PAS 99:2012** (Për sistemin e menaxhimit të integruar) e përditësuar
- **UNI EN ISO 3834-2:2006** (Kerkesat e cilesise per saldimin e materialeve metalike) e përditësuar

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020“Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë.Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, te ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor,gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të

paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësisë ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një menaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Per ISO 45001:2023: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2023, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mirë të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikat, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

- ISO 3834-2:2021 standart ky që përcakton rëndësi dhe fushëveprim të produkteve kritike të sigurisë, kompleksiteti i prodhimit, koha e përdorimit të prodhimeve të prodhuara, sfera e problemeve metalurgjike që mund të ndodhin, defektet, deformimet ose defektet e saldimit që ndikojnë në performancën e produktit në kuptimin e fushës së kualitetit të detajuar, standart dhe themelor të cilësisë ISO 3834-2.

- BS PASS 99:2012 (Sistem i Menaxhimit të Integruar). (Në zbatim të Legjislacionit për Prokurimin publik si dhe akteve nënligjore të tij, Standarti i Sistemit të Menaxhimit të Integruar garanton që operatori/operatorët ekonomik përmbushin të gjitha kërkesat standarte brenda të gjitha sistemeve të tyre të brendëshme të menaxhimit duke garantuar që ato auditohen në mënyrë të brendëshme me qëllim uljen e riskut nga ana e Autoritetit Kontraktor, përdorimin me efikasitet të burimeve të saj si dhe rritjen e efikasitetit të investimeve të kryera gjatë një viti buxhetor)

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **130 (njëqind e tridhjetë) punonjës**, me kohe të plotë pune, për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së

ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **130 (njëqind e tridhjetë)** punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, me koë të plotë pune, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Përlllogaritja e numrit total të punonjësve është bërë në bazë të manualit teknik të punimeve si më poshtë:

PREVENTIV

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	OP staf	OP staf TOTAL
		1. PUNIME SHITESASH				
1	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri >	m2	20800.0	0.010	208.00
2	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm >	m2	2100.0	0.075	157.50
3	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm >	m2	20800.0	0.075	1,560.00
4	3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri >	m3	3120.0	0.340	1,060.80
						2,986.30
		2. ANALIZA TEKNIKE				
5	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri >	m2	16000.0	0.095	1,520.00
6	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri >	m2	16000.0	1.200	19,200.00
						20,720.00
		3. PUNIME SHITESASH 2				
7	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20 (kuneta)	m3	260.0	8.600	2,236.00
						2,236.00
		4. B. SINJALET HORIZONTALE				
8	3.942	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (sprajt) >	ml	4000.0	0.100	400.00
						400.00
		5. PUNIME BETONI E BETONARMEJE				
9	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (kanali)	m3	690.2	12.800	8,834.56
10	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25(muret)	m3	3900.0	12.800	49,920.00
						58,754.56
		6. PUNIME GERMIMI				
11	3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m², ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >	m3	8064.0	0.100	806.40
12	3.124/1a	Germim shkambi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir 3 >	m3	2186.0	0.520	1,136.72
						1,943.12
		7. PUNIME DHEU				
13	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km >	m3	7130.0	0.000	-
						-
		8. PUNIME HEKUR BETONI 3				
14	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm (zgara e kanalit)	ton	20.5	61.000	1,250.50
						1,250.50
		9. PRISHJE				
15	2.426/3	Prishje shtresa betoni >	m3	258.0	18.8	4,850.40
16	2.426/5	Prishje mure betoni >	m3	695.0	16.3	11,328.50
						16,178.90
		10. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA				
17	3.189	F.V - guardrail H2 anesore me 2 valz.e ne 1 ane , W3 >	ml	3840.0	1.74	6,681.60
18	3.936	F.v. Tabela trekendore e vogel me A = 60 >	copë	19.0	0.500	9.50
						6,691.10
		11. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITESASH NGADALESUESIT E SHPEJTESISE				
19	3.955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm >	copë	10.0	0.1	1
20	3.961	F.V. Fidane Peme dekorative >	copë	55.0	1	55
		Shuma 11:				56.00

		12. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME				
21	3.322	Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M25 >	m3	15.8	9.3	146.94
22	3.400/1	Mbrojtja e shpateve nga renia e gureve me rrjete teli orjentim ne nje drejtim, me hapje heksagonale 8x10 te perforuar ne drejtimin 300gjatesor me kavo celiku anesore. >	m2	370.0	3.100	1147
		Shuma 12:				1293.94
		13. PUNIME SHPYLLEZIMI				
23	3.3	Preje e sistemim pemesh ø 10 ~ 20 cm >	copë	26.0	0.4	10.4
		Shuma 13:				10.4
		14. ANALIZA JASHTE LISTE				
24	An.1	Hapje mikrotuneli me mikrosonde per kalim te linjave te ujesjellesit/elektrike qe intersekojne rrugen kryesore >	op	33.0	0.1	3.3
		Shuma 14:				3.3
						112,523.12

Duke llogaritur totalin e orëve të punës në bazë të manualit elektronik të çmimeve ky total rezulton 112,523.12 orë pune punëtori. Duke konsideruar proceset e punës sipas grafikut të punimeve janë bere perlllogaritjet e meposhteme.

Sipas tabelës se meposhteme rezultojne 130 punonjes te kerkuar per realizimin e ketij projekti.

KAPITULLI I PREVENTIVIT				Nr I oreve te punes	Nr I oreve/pu	Nr I muajve	Nr I punonjesve te kerkuar pa perfshire dr
1. PUNIME SHITESASH				2,986.30	40	4	74.66
2. ANALIZA TEKNIKE				20,720.00	40	4	518.00
3. PUNIME SHITESASH 2				2,236.00	40	4	55.90
4. B. SINJALET HORIZONTALE				400.00	160	1	2.50
5. PUNIME BETONI E BETONARMEJE				58,754.56	400	4	146.89
6. PUNIME GERMIMI				1,943.12	40	4	48.58
7. PUNIME DHEU				0.00	40	4	0.00
8. PUNIME HEKUR BETONI 3				1,250.50	32	5	39.08
9. PRISHJE				16,178.90	53.3333	3	303.35
10. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIK				6,691.10	53.3333	3	125.46
11. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITES. NGADALE				56.00	80	2	0.70
12. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIM				1293.94	40	4	32.35
13. PUNIME SHPYLLEZIMI				10.4	53.3333	3	0.20
14. ANALIZA JASHTE LISTE				3.3	160	1	0.02
				Staf punetori		mesatarja aritmetik	96
				Drejtues teknik dhe te tjere			12
				Drejtues dhe operat makinerish			22
				TOATL			130

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, librezë pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi Infrastruktura
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndërtimi Strukturist
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Materialesh
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Mekanik
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës inxhinierik **(jo domosdoshmërisht drejtues teknik në liçencën e shoqërisë)**, si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Hidrogjeolog

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me

aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Kërkesa për 1 (një) punonjës Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rrezikët, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastruktura) janë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, me qëllimin për realizimin me cilësi dhe kushte sipas standarteve.

Inxhinieri i Ndërtimit (Profili Struktura) janë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore si pash veprat e artit si urat tombino dhe elemente të tjera strukturore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, me qëllimin për realizimin me cilësi dhe kushte sipas standarteve.

Inxhinier Hidroteknik është përgjegjës për të gjitha punimet me natyrë hidroteknike duke përfshirë kuletat/ rrjetin e kanalizimeve të ujërave të shiut referuar punimeve të parashikuara në preventiv.

Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder janë përgjegjës për saktësinë e vëllimeve të gërmimit dhe saktësinë e punimeve sipas matjeve topogjeodezike të parashikuara në projekt dhe kryerjen e azhurnimeve topografike, të cilat shtrihen në të gjithë objektin.

Inxhinier Mjedisit, do të jetë përgjegjës për të gjitha punimet që përfshijnë Inxhinierinë e Mjedisit. Ky kriter vjen si rezultat i punimeve në një qendër të banuar, me kohezgjatje punimesh relativisht të larta dhe Inxhinieri i Mjedisit do të ofrojë mundësinë e sigurimit të mbrojtjes së lartë të mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit me pasojë sa më minimale të mundshme negative në mjedis siç janë ndotja akustike dhe mjedisore . të rëndësishme në një zonë turistike si Himara .

Inxhinier Mekanik do të jetë përgjegjës për punimet mekanike ekzistuese në objekt sipas preventivit të punimeve siç janë montimet e guardrail handaril , mbrojtës së skarpave etj .

Inxhinier Gjeoteknik do të jetë përgjegjës për punimet e dherave sipas të zerave të preventivit të punimeve pasi shumica e punimeve janë nentokesore dhe në sipërfaqe të vështira malore dhe rreziku i cedimit dhe shkarjeve është i nevojshëm një specialist që njeh dhe siguron qëndrueshmërinë e tokës

Inxhinier Materialesh është e nevojshme prezencë e një **Inxhinieri materialesh** pasi në preventiv janë parashikuar punime për materiale të betonit dhe asfaltobetonit që do të jenë në prezencë të vazhdueshme të ujërave sipërfaqësore dhe nentokesore në shpatin e malit , gjithashtu do të bëhet përzgjedhja e materialit që do të mbushë trupin e rrugës të jetë sipas specifikimeve teknike . Rëndësia e cilësive të materialeve që do të perdoren në objekt është e lartë ndaj lind nevojë e një specialisti për përzgjedhjen dhe vendosjen e tyre në veçori.

Inxhinier Hidrogeolog është e nevojshme prezencë e një **Inxhinieri hidrogeolog** pasi në preventiv janë parashikuar punime dherash në prani ujërash mbi dhe nentokesore.

Nga shoqëria kërkohet dhe një azhurnim i saktë i këtij investimi në përfundim.

c) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:

- Teknik i Ndërtimi -jo më pak se **3(tre)** punonjës
- Teknik Topograf - jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Teknik Mekanik- jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Hekurthyes - jo më pak se **5 (pese)** punonjës
- Punonjës për lartësi- jo më pak se **5 (pese)** punonjës
- Kaperntier - jo më pak se **10 (dhjetë)** punonjës
- Betonues – jo më pak se **10 (dhjetë)** punonjës
- Hidraulik – jo më pak se **4 (kater)** punonjës
- Saldator – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Gurepunues- jo më pak se **2 (dy)** punonjës

- Asfaltoshtrues – jo më pak se **10 (dhjete)** punonjës

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë në listepagesat të shoqërisë minimalisht për periudhën 3 muajt e fundit.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit për diplomën/certifikatën përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me sipër.

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik Ndërtimi** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Teknik Topograf** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve topografike duke siguruar kështu kontrollin e sasisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.

- **Teknik Mekanik** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve mekanike duke siguruar kështu kontrollin e sasisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Teknik Hidroteknik** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve hidroteknike duke siguruar kështu kontrollin e sasisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Hidraulik** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik për të siguruar punimet hidraulike, bashkimet e tubacioneve sipas zerave të punimeve të preventivit të objektit.
- **Saldator** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve referuar zërave të analizave të preventivit të objektit.
- **Hekurkthyes** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen e duhur të punimeve referuar zërave të analizave të punimeve të preventivit të objektit.
- **Karpentier** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve, referuar zërave të analizave të preventivit të objektit.
- **Betonues** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve të betonit sipas zerave të preventivit të punimeve.
- **Hidroizolues** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve të betonit sipas zerave të preventivit të punimeve.
- **Gurpunues** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve të betonit sipas zerave të preventivit të punimeve.
- **Punonjes në lartësi** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve të montimit të rrjetës në skarpatat e rrugës të cilat janë punime në lartësi.
- **Asfaltorshtrues** - bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve.

Kërkesat e mësipërme bazohen në piken 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

- a) Operatori ekonomik duhet të disponojë 1(një) punojës i cili të jetë i pajisur me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM-se Nr. 312, dt 05.05.2010 "Për sigurinë në kantier", VKM-së Nr.108, dt 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të

plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.a dhe 1.b, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, Libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

b) 1 (nje) inxhinier ”Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore”, i certifikuar sipas VKM nr 125 date 23.02.2011 "Për miratimin e. Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore” dhe Udhezimit Nr 9 date 3.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurise rrugore”.
(pranohet edhe me kontrate sherbimi)

Argumentimi: **Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore** eshte nje inxhinier me rendesi ne objekte kryesisht te natyres se infrastruktures si gjate punimeve per sinjalistikën ne kantier per te shmangur aksidentet , gjithashtu dhe per zbatim sa me te mire te sinjalistikes horizontale dhe vertikale te objektit ne teresi .

c) Operatori ekonomik duhet të disponojë **1(nje) punojës** i cili të jetë i pajisur me çertifikatë “*Ekspert Zjarrfikës*” ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, Libreze pune si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, Ose te sigurohet ng opertori ekonomik nepermjet kontrakimit.

Argumentimi: Prania e një eksperti zjarrfikës në kantier pune është thelbësore për të garantuar sigurinë, mbrojtjen e jetës dhe pronës, si dhe për të siguruar përputhshmërinë me rregulloret ligjore. Më poshtë paraqiten disa argumente që mbështesin këtë kriter:

1. Parandalimi i zjarreve

Identifikimi i rreziqeve të zjarrit: Eksperti zjarrfikës analizon kantierin për të identifikuar burimet e mundshme të zjarrit, si mjetet elektrike, materialet e ndezshme ose gabimet në instalime.

Masat parandaluese: Ai vendos dhe zbaton masa për të parandaluar ndezjen, përhapjen dhe eskalimin e zjarreve, duke siguruar që mjedisi të jetë sa më i sigurt.

2. Reagimi i shpejtë në raste emergjente

Menaxhimi i incidenteve: Nëse ndodh një zjarr, eksperti zjarrfikës është i trajnuar për të ndërhyrë menjëherë, duke minimizuar dëmet dhe duke shpëtuar jetët.

Koordinimi i evakuimit: Ai krijon dhe zbaton plane të qarta evakuimi, duke udhëzuar punonjësit në mënyrë efektive gjatë një emergjence.

3. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i punonjësve

Trajnimi i stafit: Eksperti zhvillon trajnime të rregullta për punonjësit mbi përdorimin e pajisjeve kundër zjarrit (si shuarësit e zjarrit), protokollet e evakuimit dhe sjelljen e duhur në situata emergjente.

Ndërtimi i kulturës së sigurisë: Ai rrit ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e respektimit të masave mbrojtëse ndaj zjarreve.

4. Mbikëqyrja e pajisjeve dhe sistemeve kundër zjarrit

Inspektimi i rregullt: Eksperti kontrollon pajisjet kundër zjarrit në kantier (shuarësit, hidrantët, sensorët e tymit etj.) për të siguruar funksionimin e tyre të duhur.

Instalimi dhe mirëmbajtja: Ai siguron që të gjitha pajisjet dhe sistemet të jenë instaluar sipas standardeve dhe të mirëmbahen rregullisht.

5. Përputhshmëria me legjislacionin dhe standardet

Respektimi i rregulloreve: Eksperti zjarrfikës siguron që kantieri të përmbushë të gjitha kërkesat ligjore dhe standardet e sigurisë ndaj zjarrit.

Dokumentimi: Ai krijon raporte dhe mbikëqyr dosjet teknike që tregojnë përputhshmërinë e kantierit me normat e sigurisë.

- d)** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së Nr.108, datë 09.02.2011 i ndryshuar me VKM-në Nr.632, datë 15.07.2015, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. OE ofertues referuar

Ligjit Nr. 10237, datë 18/02/2010 “Per sigurinë dhe shendetin në punë”, VKM Nr. 108 datë 09/02/2011 “Për aftësin që duhet të plotësojnë punëmarrësit personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me ceshtjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar, duhet të ketë të paktën një mjek .

e) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme janë vendosur vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure

lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- Manovratore/Eskavatoriste – jo më pak se **7** (shtate) punonjës
- Manovratore/Buldozerist - jo më pak se **4** (kater) punonjës
- Automakinist – jo më pak se **4** (kater) punonjës
- Shofer – jo më pak se **7** (shtate) punonjës

, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi te Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet te perkoje me kerkesat e profilit te deklaruar per cdo punojes.
- Të figurojnë në listëpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë te regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.
- Gjate fazes se ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit eskavatoriste, automakinist, shofer, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, daten e kontrates se punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atëherë eskavatorist / buldozeristet , automakinistet, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon te drejten e verifikimit te deklarimeve per punojesit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kerkesat e mesiperme do te jete kusht per skualifikimin e ofertes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferët janë te nevojshem per shkak te makinerive te ndryshme qe do te kryejne punime germimi, ngjeshje materiali etj.

2.3.7 (Makineri, Pajisje)

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Eskavator me zinxhire mbi 35 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
2	Eskavator me zinxhire mbi 40 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
3	Eskavator me krahe te gjate mbi 20 m	1 cope	Pronësi ose me qera
4	Eskavator me krahe te gjate mbi 18 m	1 cope	Pronësi ose me qera
5	Fadrome me goma MT	2 cope	Pronësi ose me qera
6	Minifadrome MT	1 cope	Pronësi ose me qera
7	Kamion vetëshkarkues min 25 ton	4 cope	Pronësi ose me qera
8	Kamion vetëshkarkues 10-12 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
9	Rimorkiator për transportin e makinerive me kapacitet mbajtës min 25 ton.	1 cope	Pronësi ose me qera
10	Koke Terheqese	1 cope	Pronësi ose me qera
11	Rimorkiator për transportin e makinerive me kapacitet mbajtës min 50 ton.	1 cope	Pronësi ose me qera
12	Dumper mbi 25 ton MT	1 cope	Pronësi ose me qera
13	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10 – 18 ton	4 cope	Pronësi ose me qera
14	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
15	Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 7	1 cope	Pronësi ose me qera
16	Eskavator me goma mbi 10 ton MT	2 cope	Pronësi ose me qera
17	Autobetoniere kantieri MT	2 cope	Pronësi ose me qera
18	Vibrator Betoni	4 cope	Pronësi ose me qera
19	Makineri per montim guardrail	1 cope	Pronësi ose me qera
20	Makineri Vijezi	1 cope	Pronësi ose me qera
21	Minieskavator me zinxhir gome	2 cope	Pronësi ose me qera
22	Autobot uji	2 cope	Pronësi ose me qera

23	Autobetoniere	2 cope	Pronësi ose me qera
24	Autopompë betoni	2 cope	Pronësi ose me qera
25	Grejder MT	2 cope	Pronësi ose me qera
26	Asfaltoshtruese	3 cope	Pronësi ose me qera
27	Autobitumatrice	2 cope	Pronësi ose me qera
28	Pajisje per largim te ujrave nentokesore me sistemin gjilperthithese (Well Point)	1 cope	Pronësi ose me qera
29	Rrul gome-hekur mbi 20 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
30	Rrul me dhembe mbi 15 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
31	Gjenerator	2 cope	Pronësi ose me qera
32	Sonde mikrotunelesh per çpime horizontale me drejtim me lazer per tuba DN 200-400	1 cope	Pronësi ose me qera
33	Autovinc mbi 18 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
34	Saldatrice	3 cope	Pronësi ose me qera
35	Tokmak elektrik	2 cope	Pronësi ose me qera
36	Rrul gome-hekur mbi 18 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
37	Rrul ngjeshes asfalti min 8 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
38	Buldozer	2 cope	Pronësi ose me qera
39	Sonde shpimi (per montim rrjete mbajtese skarpate)	1 cope	Pronësi ose me qera
40	Damper me goma kapacitet mbajtes 5-10 ton MT	2 cope	Pronësi ose me qera
41	Autofshese MT	1 cope	Pronësi ose me qera
42	Matrapik	3 cope	Pronësi ose me qera
43	Depozita uji minimumi 5000 litra	2 cope	Pronësi ose me qera
44	GPS	1 cope	Pronësi ose me qera
45	Total Station	1 cope	Pronësi ose me qera
46	Kontenier (Zyrë Kantieri)	1 cope	Pronësi ose me qera
47	Impiantin e prodhimit te betoni, (jo me shume se 50 km larg objektit)	1 cope	Pronësi/qera/kontrate furnizimi
48	Impiantin e prodhimit te asfaltobetonit, (jo me shume se 50 km larg objektit)	1 cope	Pronësi/qera/kontrate furnizimi

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 125 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme – *jo më pak se 12 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 45 copë*
- Semafor rruge – *jo më pak se 4 copë*

❑ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- **Për mjetet e siguruara me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- **Për pajisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimit*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- **Për pajisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimit*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomikë të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor

se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

Shënim: Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në katër fronte me shtrirje të gjerë gjeografike, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

- Kamion vetshkarkues me kapacitet 10-12 , 12-18 ,18-25 , mbi 25 ton . Jane mjete te domosdoshme ne transportin e materialit drejt pikes se depozitimit te inerteve duke u pershtatur dhe me ngarkesen , tonazhin e lejuar ne disa rruge , funksionalitetin etj
- Dumper 20-30 ton referuar analizave 3.124/1a, 3.89/b jane te nevojshem sepse terreni eshte shume i veshtire , me prezenc baltrash dhe pjerresi e madhe , jane me 6 akse dhe mundesojne levizjen ne keto terrene ndryshe nga kamjonat qe e kane te pamundur, gjithashtu sasia e madhe e materialit qe transportohet ne nje kohe te shkurter e ben te domosdoshem perdorimin e ktyre mjeteve.
- Rimorkiator për transportin e makinerive me kapacitet mbajtës min 30 , 50 ton , jane makineri te domosdoshme per transportin e makinerive te renda ne kantier .
- Eskavator me zinxhir min 25, 35 , 40 ton , referuar analizave 3.124/1a, 3.89/b jane mjete te domosdoshme sepse sasia e germimit eshte > 5000 m3 dhe koha eshte shume e shkurter .
- Eskavator me krahe te gjate min 21 m , referuar analizave 3.124/1a, 3.89/b dhe projektit eshte I domosdoshem nje mjet me krahe te gjate pasi bazuar ne projekt dhe ne terren ka zona ku eshte e pamundur germimi me mjete te tjera gje qe e ben te domosdoshem nevojen e nje eskavatori me krahe te gjate .
- Eskavator me goma , fadrome me goma , minieskavator me goma 3.5-5ton, minifadrome , minieskavator me zinxhir gome - mjete te nevojshme per punimet ne rruge pa demtuar shtresat asfaltike , gjithashtu mjete me tonazh te ulet qe qe mund te futen ne hapësira te ngushta
- Kamionçine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-2 ton, e nevojshme per transporte te ndryshme jashte dhe Brenda kantierit dhe transporte te vogla puntoresh dhe materiale te vogla .

- Autopompe betoni, e nevojshme per betonim te mureve mbajtes dhe prites
 - Autobetoniere, e nevojshme per per betonim te mureve mbajtes dhe prites
 - Betoniere Kantieri, per betonim te mureve mbajtes dhe prites
 - GPS , e nevojshme per matjet dhe planvendosjen e sakte te objektit
 - Ekskavator me zinxhire, referuar punime germimi
 - Kamion veteshkarkues me kapacitet 3,5 – 5 ton, e nevojshme per transporte te ndryshme jashte dhe Brenda kantierit dhe transporte te vogla puntoresh dhe materiale te vogla .
 - Grejder, i nevojshem per perhapjen e njetratjeshem te shtresave pergjate gjithë segmentit
 - Pajisje per largim te ujrave nentokesore me sistemin gjilperthithese (Well Point), sipas preventivit te punimeve
 - Sonde mikrotunelesh per çpime horizontale me drejtim me lazer, sipas preventivit te punimeve
- Analiza An
- Rrul me dhembe mbi 15 ton, i nevojshem per ngjeshjen e shtresave ne kombinim me grejderin dhe mjete te tjera teknologjike
 - Rrul ngjeshës mbi 18 ,20 ton,i nevojshem per ngjeshjen e shtresave ne kombinim me grejderin dhe mjete te tjera teknologjike,
 - Rrul 1 -3 ton , mjet I nevojshem per ngjeshje te shresave ne hapësira te ngushta per punime civile te vogla si bankinat
 - Vibrator betoni i jashtem, per betonimin e strukturave te armuara
 - Buldozier , makineri e domosdoshme per spostimin e masivit te dheut
 - Autovinc mbi 20 ton , mjet I nevojshem per shkarkimin e ngarkesave te renda si tubacionet , zgarat metalike , paneleve ,
 - Makineri per pilotat , makineri e domosdoshme ne veprat e artit si urat per mbjtjet nga shkarjet e dheut
 - Sonde shpimi per montim rrjete ne skarpate sipas preventivit te punimeve 3.400/1

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

2.3.8 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin perkates për produktet e meposhtme duhet te paraqiten:

- **Boje Bikomponente Spray** Duhet te paraqiten: Autorizim prodhuesi/distributori, Ne rast paraqitje Autorizim distributori duhet te paraqitet marreveshje angazhimi mes prodhuesit dhe distributorit (e vlefshme), Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente
- **Tubat e brinjezuar HDPE**. Duhet te paraqiten: Autorizim prodhuesi/distributori, Ne rast paraqitje Autorizim distributori duhet te paraqitet marreveshje angazhimi mes prodhuesit dhe distributorit (e vlefshme), Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmimit CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi

Fidane, peme dekorative Autorizim prodhuesi/distributori, Ne rast paraqitje Autorizim distributori duhet te paraqitet marreveshje angazhimi mes prodhuesit dhe distributorit (e vlefshme), Duhet te paraqiten: Çertifikatë Fitosanitare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe proporcion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë e dhe natyrën e punimeve, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së punimeve. Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuarit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuari është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuari. Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit te cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet shërbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Gjithashtu në bazë të nenit 4, nenit 36 si dhe nenit 79 pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 .Ky kriter është vendosur që AK të ketë siguri që operatori ekonomik që do të ofertojë të jetë i pajisur me certifikatat e mësipërme, të lidhura me objektin e prokurimit, gjë e cila krijon bindjen dhe siguri të Autoritetit Kontraktor që ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës. Në nenin 44 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit Kjo kërkesë është kërkuar që të sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësi e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuari/distributori, me të cilin prodhuari/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuari mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të

verifikoje qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike .

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te kete kontratë me një laborator të akredituar ku të jetë përcaktuar objekti i kontratës/procedurës, për kryerjen e testeve gjatë fazës së zbatimit si dhe përfundimit të objektit. Laboratori duhet të jetë i akredituar për testet e poshtë shënuar, të certifikuar në përputhje me SSHEN 12390-3:2019 ASTM C39/C39M, SSH EN 1744- 1:2009+A1:2012, SSHEN 12390-3:2019 ASTM C39/C39M.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave qe do te ofertohe, është kërkesë ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, apo marrëveshje bashkëpunimi, duke treguar origjinalitetin e tyre dhe ofruar garanci per mallrat qe do të furnizohen.”

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë liçencë të vlefshme:

Kodi III.2.B – *”Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve të ndryshme inerte dhe dhera si mbetje te parrezikshme (mbetjet që dalin nga punimet)” sipas kodeve:*

- 17 05 04 Dhera dhe gure
- 17 05 06 Balta
- 17 05 08 Cakell
- 19 12 09 Minerale (p.sh rere, gure)
- 17 01 07 Perzierje te betonit
- 12 01 13 Mbetjet nga saldimet
- 20 02 01 Mbetje te biodegradueshme

Argumentimi: Të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në grumbullim dhe transportim mbetjesh, duke përfshirë por jo përjashtuar mbetjet e ngurta inerte, duhen të pajisen me lejen e posaçme me kod III.2.B, e cila siguron përputhshmërinë me anën ligjore dhe teknike të legjislacionit, duke siguruar mbledhjen, grumbullimi, transportin dhe depozitim të mbetjeve sipas standarteve të kërkuara dhe në mbrojtje të mjedisit. Argumentim i kriterit të vendosur në pikën 2.3.14 të dokumenteve të tenderit

Kriteri që kërkon që operatori ekonomik të jetë i pajisur me liçencën përkatëse të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL), konkretisht me Liçencën me Kodin III.2.B – “Për

grumbullim dhe transportim të mbetjeve të ndryshme inerte dhe dhera si mbetje të parrezikshme”, është një kriter i domosdoshëm për realizimin e kontratës.

Objekti i kontratës përfshin realizimin e punimeve që gjenerojnë sasi të konsiderueshme mbetjesh inerte dhe dheu, si pasojë e gërmimeve, prishjeve të elementeve ekzistuese, përpunimit të betonit, pastrimit të ambienteve, si dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës. Në mënyrë që këto mbetje të trajtohen në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi, është detyrim ligjor që transportimi dhe grumbullimi i tyre të kryhet vetëm nga subjekte të licencuara për këtë aktivitet.

Kodi III.2.B mbulon llojet e mbetjeve që parashikohen të gjenerohen gjatë zbatimit të kësaj kontrate, sipas klasifikimeve të BE-së dhe vendore për mbetje të parrezikshme:

12 01 13: Mbetje nga saldimet,

17 01 01: Beton,

20 02 02: Dhera dhe gurë,

20 03 04: Llumra,

20 03 06:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar, preventivin si dhe analizen e cmimeve për zerat e preventivit, (Bashkëlidhur DST) në dokumentat e tenderit. Në rast BOE, grafikun e punimeve duhet të jetë i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

Specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.162/2020 “ Per prokurimin Publik” dhe nenit 78 pika 2 e VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinier i licensuar dhe do të bashkengjiten dokumentave të tenderit në SPE.

NJESIA E PROKURIMIT